



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



**ZKA**

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT  
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE  
NATIONAL AUDIT OFFICE

# RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS PËR VITIN 2024

Prishtinë, maj 2025

# PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

# 1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.<sup>1</sup>

## Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Gjakovës (KGj), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera<sup>2</sup>, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Gjakovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

## Baza për Opinion të Kualifikuar

- A1 Të hyrat e prezantuara në vlerë 5,844,817€, në Pasqyrat Financiare Vjetore ishin të nën vlerësuar për 17,954€.
- B1 Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2024 transaksione në vlerë 1,341,947€, ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate.
- A2 Llogaritë e arkëtueshme ishin nënvlersuar për 222,984€.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

## Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Gjakovës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

## Baza për konkluzion

- A3 Në dy (2) raste të kontratave publike kornizë për furnizime me çmime për njësi ishin tejkalluar vlerat e lejuar për shpenzim sipas peshimit nga 9% e deri në 28%.
- B2 Në kontratat e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve. Në tre raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë, vonesat ishin mbi 90 ditë.
- B3 Nga testimi i tre (3) mostrave në vlerë totale prej 227,894€, për obligimet e papaguara kemi vërejtur se pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 14 deri 150 ditë kalendarike.
- A4 Komuna në pesë (5) raste gjatë blerjes së mallrave nuk i kishte themeluar komision për pranimin të tyre siç kërkohet me Rregulloren nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo Financiare Qeveritare.
- A5 Faturimi për pozicione që nuk ishin specifikuar qartë në paramasën dhe paralogarinë e kontratës.

*Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë*

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

## **Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore**

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Gjakovës.

## **Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë**

Menaxhmenti i Komunës së Gjakovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.<sup>3</sup>

## **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Gjakovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticism profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Gjakovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

## 2 Gjetjet dhe rekomandimet<sup>4</sup>

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha ku nevojitet përmirësim për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Procesi i raportimit në Komunë ishte përcjell me mangësi, kjo ishte vërejtur edhe me rastin e përgatitjes së Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV), të cilat kanë përmbajtur gabime në prezantimin dhe shpalosjen e informatave. Pas kërkesës tonë disa çështje të ngritura në PFV-të janë korrigjuar dhe dorëzuar në MF. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi evidentuar mangësi në menaxhimin e të hyrave, llogarive të arkëtushme, klasifikimin e shpenzimeve, menaxhimin e projekteve kapitale, si dhe në procedurat e prokurimit publik të cilat janë paraqitur më poshtë në forme të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korrigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 13 rekomandime, prej tyre tetë (8) janë rekomandime të reja dhe 5 (pesë) të përsëritura.

Nga mostrat e testuara kemi vërejtur se si rezultat i kontratës kolektive me procedurë përmbartimore gjyqësore komuna ka paguar borxhin kryesor në shumë 3,277,015€ për paga dhe meditje, ndërsa shpenzimet shtesë të interesit dhe procedurale të gjykatës/përmbartimit ishin 385,756€.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

### 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

#### Çështja A1 - Aplikim jo i drejtë i taksës komunale nga Drejtoria e urbanizimit

##### Gjetja

Udhëzimi Administrativ MMPH nr 02/18 për taksat e administrative për leje ndërtimore, leje rrërimi dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës, neni 11, paragrafi 1 specifikon se “tarifa rregullative për rritjen e densitetit të infrastrukturës caktohet duke pjesëtuar sipërfaqen neto të njësisë së re të banimit me numrin e supozuar të banorëve të secilës njësi të re banuese shumëzuar me tarifën për kokë banori”, Po ashtu paragrafi 3 përkufizon se “vetëm hapësira e re e banimit duhet të përdoret gjatë llogaritjes. Shuma e hapësirës së banimit aktuale ose që ka ekzistuar më parë duhet të përjashtohet” sikurse që e parasheh paragrafi 4 që përkufizon se “çdo hapësirë në ndërtim që nuk përdoret për banim duhet të përjashtohet nga llogaritja”.

Në tri (3) raste kemi vërejtur se Komuna kishte bërë gabim gjatë llogaritjes së tarifës së densitetit duke i përfshirë sipërfaqet ekzistuese në llogaritje e jo sipërfaqet e reja siç e parasheh udhëzimi administrativ nr 02/18 dhe si pasojë kjo ka shkaktuar që të hyrat e inkasuara të komunës të jenë më të ulta për 17,954€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme, gjatë llogaritjes së tarifës së densitetit.

##### Ndikimi

Mungesa e kontrolleve efektive të komunës tek aplikimi i taksës së

infrastrukturës për rritjen e densitetit, nga ana e komunës ka ndikuar që të kemi nivel më të ulët të të hyrave të cilat duhej të ishin realizuar.

**Rekomandimi A1** Kryetari duhet të analizojë shkaqet e aplikimit jo të drejtë të tarifës për infrastrukturë dhe rritje të densitetit, dhe menjëherë të marrë masa korigjuese në mënyrë që të hyrat nga kjo tarifë të jenë të plota dhe të sakta.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve**

**Gjetja** Rregulla financiare nr. 01/2013/MF “Mbi shpenzimin e parasë publike”, neni 18 pika 3 specifikon se shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël.

Përmes pagesave direkte nga Thesari bazuar në vendime gjyqësore gjatë vitit 2024 transaksione në vlerë 1,341,947€ ishin realizuar për pagat jubilarë dhe shujta nga kategoria ekonomike joadekuate. Prej tyre nga investimet kapitale ishin realizuar 1,219,223€, nga mallrat dhe shërbimet 106,622€, si dhe nga subvencionet 16,102€. Nga kjo vlerë shpenzimet shtesë gjyqësore/përmbarimore janë në vlerë prej 411,456€.

Pagesat për paga jubilarë dhe shujta kanë ndodhur si rezultat i kontratës kolektive, shpenzimet e të cilave nuk kanë mundur të planifikohen me buxhet.

**Ndikimi** Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve nga kategoritë ekonomike jo adekuate, ndikon në mbivlerësimin/nënvlerësimin e kategorive përkatëse të shpenzimeve dhe të pasurive. Si rrjedhojë ndikon në prezantim jo të drejtë të shpenzimeve në PFV.

**Rekomandimi B1** Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A2 - Nënvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

**Gjetja** Rregullorja nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiar, neni 16, përcakton se Organizatat buxhetore që mbledhin të hyra janë të detyruara të mbajnë regjistra të të hyrave të mbledhura dhe shumave të faturuara e të pa arkëtuara. Të arkëtueshmet shpalosen në raportin vjetor financiar në tabelën përkatëse sipas llojit të hyrave.

Komuna ka raportuar në PFV, Llogari të arkëtueshme në vlerë prej 14,359,438€. Ne kemi identifikuar se në katër (4) raste ishin lidhur marrëveshje me aplikuesit e lejeve për pagesën me këste të lejeve ndërtimore bazuar në rregulloren komunale për taksa. Në fund të vitit 2024, shfrytëzuesit e lejeve kishin mbeture obligim ndaj Komunës shumë prej 222,984€, të cilat nuk ishin raportuar në PFV si llogari të arkëtueshme.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të kontrolleve në

menaxhimin e regjistrin të llogarive të arkëtueshme, ku marrëveshjet për pagesën e lejeve ndërtimore me këste nuk ishin përfshirë në regjistrin e llogarive të arkëtueshme.

**Ndikimi**

Mos prezentimi i drejtë i llogarive të arkëtueshme ndikon në shpalosjen e informatave jo reale për palët e interesit përkatësisht shfrytëzuesit e pasqyrave financiare.

**Rekomandimi A2**

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve të brendshme, në mënyrë që të përmirësohet procesi i menaxhimit dhe prezentimit të drejtë të llogarive të arkëtueshme në PFV.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

## 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

### Çështja A3 - Tejkallim në realizimin e sasive të kontratave publike kornizë, në mos përputhje me peshët e përcaktuara në dosje të tenderit

#### Gjetja

Rregullorja nr.001/2022 për prokurimin publik, neni 17.35, përcakton se "Kurdo që Autoriteti kontraktues nuk din sasi të indikative, kontratat me çmime për njësi, AK duhet të përcaktoj peshët në bazë të rëndësisë së secilës "kategori të shërbimeve" në mënyrë që AK të përcaktoj se cila është oferta me çmim më të ulët në baze të poentimit. Si rrjedhojë, peshimi i artikujve duhet bërë bazuar në peshën dhe rëndësinë e kategorisë përkatëse, që do të thotë se sasia e realizuar (shpenzuar) nuk mund dhe nuk duhet të ndryshoj nga raportet sipas peshës së dhënë në Dosjen e Tenderit.

Menaxheri i kontratës mbetet përgjegjës që të dëshmoj në mënyrë të qartë se sasia e porositur dhe shpenzuar është në harmoni me peshën e dhënë dhe me nevojat reale të autoritetit kontraktues".

Në dy kontrata publike kornizë me çmime për njësi, vlera e shpenzuar e një kategorie të caktuar, ka tejkalluar vlerën e lejuar për shpenzim sipas peshimit. Bëhet fjalë për kontratat si në vijim:

- Në kontratën "Mbikëqyrja profesionale e projekteve" në vlerë të parashikuar prej 170,000€, e cila deri me datën 31.12.2024 ishte realizuar në vlerën prej 91,758€, tek pozicioni 1 "mbikëqyrja dhe pranimi i punimeve në rrugë dhe objekte të rrugëve" në dosjen e tenderit i ishte dhënë peshë prej 30% në bazë të rëndësisë. Ky pozicion ishte më së shumti i faturuar. Nga analiza e realizimit deri tani për këtë pozicion janë paguar 65,302€, pra kemi tejkallim për 28% apo 14,302€.
- Në kontratën "Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët" në vlerë të parashikuar prej 180,000€, e cila deri me datën 31.12.2024 ishte realizuar në vlerën prej 122,316€, pozicionit B "rrugët dhe objektet e rrugës" në dosjen e tenderit i ishte dhënë peshë prej 60% në bazë të rëndësisë. Ky pozicion ishte më së shumti i faturuar. Nga analiza e realizimit deri tani për këtë pozicion janë paguar 84,398€, pra kemi tejkallim për 9% apo 11,008€.

Këto tejkallime kishin ndodhur si pasojë e planifikimit jo të mirë të nevojave dhe përcaktimit jo të duhur të peshimit të kategorive në bazë të rëndësisë së punëve/shërbimeve në dosjen e tenderit.

#### Ndikimi

Tejkallimi i shpenzimit të sasive të lejuara sipas peshës që iu është caktuar në dosjen e tenderit dhe në kontratë, ndikon në mungesë të transparencës në vendimmarrjen për zgjedhjen e ofertës me çmimin më të ulët. Kjo poashtu, mund të ndikojë në rritjen e shpenzimeve të planifikuara buxhetore.

#### Rekomandimi A3

Kryetari duhet të sigurojë përmes njësive kërkuese, që gjatë përgatitjes së kërkesave dhe dosjeve të tenderit për kontratat publike kornizë sipas peshimit, të luaj një rol aktiv në përcaktimin e nevojave reale të komunës, në mënyrë që këto kontrata të realizohen në pajtueshmëri të plotë me peshët e përcaktuara në dosjen e tenderit.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)****Çështja B2 - Vonesa në përfundimin e punëve të kontraktuara****Gjetja**

Rregulla nr. 01/2022 për prokurim publik taksativisht në neni 70.23 pika b parashihet se menaxheri i kontratës duhet të sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. Në kontratat publike të nënshkruara mes komunës dhe kontraktuesëve, përcaktohen kushtet e veçanta kontraktuale si dhe afati kohor për realizimin e projektit. Menaxherët e kontratave duhet të monitorojnë dhe të sigurojnë se kontratat po realizohen si duhet dhe në afatin e përcaktuar.

Në kontratat e nënshkruara ndërmjet Komunës dhe operatorëve ekonomik përcaktohet afati kohor për realizimin e punimeve. Në tri (3) raste, kemi vërejtur që punimet nuk ishin realizuar sipas planit dinamik siç parashihej me kontratë. Rastet e identifikuar janë:

- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Dalja për Pejë -pjesë e qarkores së Qytetit”, segmenti i dytë -faza e dytë”, në vlerë 1,111,154.72€ ishte nënshkruar me datë 07.06.2023. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 215 ditë pune. Vlera e punëve të realizuara deri me 31.12. 2024, duke përfshirë edhe aneksin prej 110,762€ të lidhur me 31.07.2024, ishte 993,809€, apo 81% e vlerës së kontratës bazë dhe aneksit. Duke pasur parasysh se plani dinamik i kryerjes së punëve në këtë projekt ishte poentuar me 30% gjatë vlerësimit të këtij tenderi.
- Kontrata “Ndërtimi i rrugës Dalja për Pejë -pjesë e qarkores së Qytetit”, në vlerë 2,985,382€ ishte nënshkruar me datë 13.07.2023. Sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 200 ditë pune. Vlera e punëve të realizuara deri me 31.12. 2024, duke përfshirë edhe aneksin prej 293,643€, të lidhur me 19.07.2024, ishte 2,641,044€, apo 81% e vlerës së kontratës bazë dhe aneksit. Duke pasur parasysh se plani dinamik i kryerjes së punëve në këtë projekt ishte poentuar me 30% gjatë vlerësimit të këtij tenderi.
- Kontrata “Ndërtimi asfaltimi i rrugëve në fshatin Meqë” në vlerë 127,000€, e nënshkruar më datë 21.08.2024, sipas kontratës data e fillimit të punëve ishte menjëherë pas nënshkrimit të kontratës, dhe përfundimi për 90 ditë pune. Vlera e punëve të realizuara deri me 31.12. 2024, ishte 80,600.72€, apo 63% e vlerës së kontratës bazë.

Pra në tri projektet janë evidente vonesat në kryerjen e punëve sipas planit dinamik të paraparë me kontratë për të cilat komuna nuk kishte aplikuar ndonjë masë ndëshkuese.

Arsyet apo shkaqet e vonesave ishin mungesa e një analize të mirëfilltë para inicimit të projekteve kapitale, si dhe kohën e parashikuar për realizimin e këtyre projekteve, por edhe dobësitë në hartim të projekteve, ku gjatë realizimit të punëve është vërejtur mospërshtatje me gjendjen e terrenit.

**Ndikimi**

Vonesat në përfundimin e projekteve ndikojnë që komuna të mos arrijë objektivat e përcaktuara në vitin aktual dhe njëherësh mund të shkaktojnë vështirësi buxhetore për vitet pasuese. Mos aplikimi i penaleve për vonesat

e shkaktuara paraqet devijim nga kërkesat ligjore dhe kushtet e kontratës.

**Rekomandimi B2** Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigoroze në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave**

**Gjetja** Ligji nr. 03 /L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, neni 39.1 përcakton që secila faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagesë të mallrave dhe shërbimeve të paguhet brenda 30 ditëve kalendarike pas marrjes së faturës. Ndërsa, sipas nenit 40, fatura mund të ekzekutohet direkt nga Thesari pas marrjes së urdhërit të prerë nga gjykata/përmbaruesi.

Krahasuar me vitin e kaluar kemi një rritje të obligimeve të papaguara nga komuna në vlerë prej 211,918€, apo në përqindje prej 21%. Nga testimi i tre (3) mostrave në vlerë totale prej 227,893€, për obligimet e papaguara kemi vërejtur se pagesat nuk ishin bërë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Vonesat ishin nga 14 deri 150 ditë kalendarike.

Shkak i mos pagesës me kohë të detyrimeve është hyrja në obligime kontraktuale pa fonde të mjaftueshme.

**Ndikimi** Hyrja në obligime pa siguruar fondet e nevojshme, ndikon në rritjen e obligimeve të papaguara apo implikimeve buxhetore për vitin aktual, si dhe kosto financiare si rezultat i ngarkesave shtese në emër të kamatave dhe shërbimeve të përmbarimit.

**Rekomandimi B3** Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimit të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbarimore.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A4 - Pranimi pa komision i mallrave dhe furnizimeve tjera kapitale**

**Gjetja** Rregullorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare qeveritare paragrafi 4 i nenit 8 të përcakton se "Zyrtari Kryesor Administrativ me vendim formon Komisionin për Pranimin e Pasurisë jo Financiare që ka përgjegjësitë të bëjë verifikimin e sasisë, cilësisë, llojin dhe vlerën e pasurisë jo financiare të pranuar dhe të dokumentuar me procesverbal që janë në përputhshmëri me kontratën apo urdhërblenjen".

Në pesë (5) mostra të testuara me vlerë prej 298,116€, për furnizim me vetura zyrtare, furnizim me pajisje për shkollë të muzikës, furnizim me inventar për objektin e ri, kemi vërejtur se Zyrtari Kryesor Administrativ nuk kishte themeluar komision për pranim. Më tutje edhe pranimi i furnizimeve

mjekësore në vlerë 13,948€ dhe furnizimeve tjera për material higjenik në vlerë 4,185€, nuk janë pranuar me komision dhe nuk janë evidentuar përmes depos sipas kërkesave të rregullores. Po ashtu edhe furnizimi me dru dekorativ në vlerë 32,370€, në komunë nuk ishte bërë nga komisioni.

Në keto raste të identifikuara kemi vërejtur se mallrat dhe shërbimet ishin pranuar vetëm nga projekt menaxherët e kontratave e jo nga komisionet e pranimit siq e kërkon rregullorja nr. 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive jo financiare.

Kjo kishte ndodhur për shkak të se zyrtarët komunal tek pjesa e pranimit të mallrave apo furnizimeve nuk kishin marrë për bazë kërkesat e rregullores adekuate por ishin bazuar në rregulloren e prokurimit publik

**Ndikimi** Pranimit i mallrave dhe furnizimeve në mungesë të komisioneve të pranimit rritë rrezikun se mallrat apo furnizimet mund të mos pranohen sipas cilësisë, kushteve dhe elementeve tjera të përcaktuara në kontratë.

**Rekomandimi A4** Kryetari duhet të siguroj se për çdo furnizim të mallrave, pajisjeve të cilat komuna i blen apo i përvetëson duhet të themeloj komision konformë rregullores 02/2013, në mënyrë që të ofrohet siguri se furnizimet e pranuar janë konformë kushteve të kontratës.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

#### **Çështja A5 - Faturimi i pozicioneve jo konformë paramasës dhe parallogarisë së kontratës**

**Gjetja** Rregulla financiare nr 01/2013 MF-Shpenzimi i parave publike, neni 25 paragrafi 1.2 përcakton se zyrtari çertifikues duhet "Të siguroj që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para regjistrimit të shpenzimit në SIMFK dhe autorizimit të pagesave".

Tek pagesa/fatura në vlerë prej 42,991€, e realizuar për kontratën "Hartimi i projekteve të ndërtimit të ulët" kemi vërejtur se fatura është lëshuar për "Projektin e liqenit në lumin Erenik". Gjatë krahasimit të pozicioneve të faturuara dhe pozicioneve të paramasës dhe parallogarisë së kontratës, kemi vërejtur se mungon pozicioni për projektim të liqeneve. Komuna kishte shfrytëzuar pozicione tjera të ujrave dhe hapsirave publike për të realizuar projektin në fjalë. Ky pozicion nuk është parashikuar specifikisht në kontratë dhe rrjedhimisht ky faturimi nuk ishte adekuat me pozicionet e kontratës.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme në mbikëqyrjen e projekteve si dhe mungesa e kontrolleve përkatëse gjatë certifikimit.

**Ndikimi** Faturimi i artikujve që nuk janë në specifikacionin e kontratës ndikon që komuna të paguajë çmime më të larta se sa që ofrohen në treg, dhe kjo njëherit nuk ka bazë të qartë ligjore.

**Rekomandimi A5** Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovjnë situacione të punëve të pa specifikuara qartë me kontratë, si dhe asnjë pagesë të mos çertifikohet jashtë paramasës së kontratave.

#### **Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



## 2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

### 2.3.1 Të hyrat

Të hyrat vetjake të realizuara në vitin 2024 ishin në vlerë 5,844,817€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Përveç të hyrave vetanake, komuna këtë vit ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku në vlerë totale prej 1,284,021€, si dhe të hyra nga gjobat e gjykatës në vlerë 63,154€.

#### Çështja A6 - Mangësi në raportimin e rregullt për shfrytëzim të pronave komunale

<b>Gjetja</b>	<p>Ligji nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 22 paragrafi 2 përcakton se; Kryetari i Komunës obligohet që në raportet e tij të rregullta gjashtë (6) mujore ti paraqet Kuvendit të Komunës edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.</p> <p>Në vitin 2024 Komuna e Gjakovës kishte lidhur (32) kontrata të reja për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale, dhe kishte shkëputur shtatë (7) të tilla. Zyrtarët komunal nuk arritën të na sigurojnë dëshmi se Kryetari i Komunës kishte raportuar para kuvendit komunal (kërkesë kjo mandatore) raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme, deri në fillimin e implementimit dhe arritjes së qëllimit të dhënies së pronës në shfrytëzim.</p> <p>Shkak i ndodhjes është anashkalimi i kërkesave ligjore në lidhje me raportimin dhe mbikëqyrjen e kontratave për shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale.</p>
<b>Ndikimi</b>	<p>Mungesa e raportimit për monitorimin e kontratave për pronat komunale të dhëna në shfrytëzim, përveç se krijon pa pajtueshmëri ligjore, kjo ndikon që kontratat e dhëna mos të realizohen në pajtim me kërkesat ligjore.</p>
<b>Rekomandimi A6</b>	<p>Kryetari duhet të sigurojë se raportimi (6) mujore në kuvendit komunal të përmbajnë edhe raportimin e veçantë për monitorimin e realizimit të kontratave dhe përmbushjes së qëllimit të dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme.</p>

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.2 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale në vitin 2024, ishte 15,836,936€, prej tyre ishin shpenzuar 14,767,031€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për rregullimin e infrastrukturës rrugore, ndërtimin e kanalizimeve, ndërtimin e ujësjellësit etj.

### Çështja B4 - Mangësi në pagesa për projektin kapital

**Gjetja** Rregulla financiare nr.01/2013 MF shpenzimi i parave publike, neni 41, paragrafi 2, përcakton se “Organizata buxhetore është e obliguar që ti marr të gjitha hapat e nevojshëm që malli dhe shërbimi i porositur është pranuar në pajtim me kushtet e kontratës dhe urdherblerjes. Për të gjitha mospërputhjet eventuale duhet në afatin e përcaktuar nga pika 1 e këtij neni t’i harmonizoj me furnitorin në mënyrë që fatura të paguhet në afatin e përcaktuar ligjor.”

Gjatë testimit të pagesës me vlerë 86,178€ për projektin “Zgjerimi i rrugës Martirët e Kombit/Hyrja Perëndimore e Qytetit”, ishte paguar shuma prej 2,250€ më shumë sesa ishin realizuar punët për këtë projekt, edhe pse ende nuk janë kryer të gjitha situacionet për këtë projekt.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme dhe mbikëqyrjes së dobët nga menaxherët e kontratave gjatë realizimit të projektit kapital.

**Ndikimi** Pagesa e punëve të porealizuara ndikon që kontrata të mos realizohet sipas kushteve të parapara si dhe njehërit ndikon në dëmtimin e buxhetit të komunës.

**Rekomandimi B4** Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara, dhe të mos paguhen punët jashtë paramasës së kontratës.

### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

**Çështja A7 - Përdorimi i shpeshtë i aneks kontratave****Gjetja**

Sipas Rregullores 001/2022 për prokurim publik, neni 13, paragrafi 4 parashikon se “Një kontratë nuk mund të vazhdohet, të përtërihet ose të përcjellët nga një kontratë pasuese pa administrimin e procedurës së re. Megjithatë, brenda një shumë prej 10% të vlerës së kontratës një kontratë për furnizime/shërbime/punë shtesë, të cilat nuk ishin përfshirë, dhe as kryer në kontratën origjinale, por të cilat për arsye të paparashikueshme, janë bërë të domosdoshme për ekzekutimin e kontratës, mund të realizohet si kontratë shtesë përmes procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë. Kur një kontratë e tillë shtesë është relativisht e parashikueshme, vlera e tillë duhet të përfshihet në vlerën origjinale të parashikuar të kontratës” si dhe neni 48 paragrafi 4 kërkon që” Megjithatë, kërkesat e neni 35.3 të LPP-së do të merren parasysh nga autoriteti kontraktues: Zhvillimi i një procedure të negociuar pa publikuar njoftimin e kontratës në asnjë mënyrë nuk do t’ia heq autoritetit kontraktues obligimet e veta për të: a. Luajtur një rol aktiv në vendosjen e kushteve të kontratës, posaçërisht lidhur me çmimet, afatet e dërgesave, sasisë, karakteristikave teknike dhe garancionet; b. Sigurojë se çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi përkatës i tregut; dhe c. Vlerësojë me kujdes cilësinë e produktit në fjalë, të shërbimeve, apo punimeve”.

Komuna gjatë vitit 2024 kishte lidhur 24 aneks kontrata për punë shtesë në vlerë prej 1,118,290€, (sipas raportit të kontratave të nënshkruara kontrata të rregullta jo anekse për punë në total gjatë vitit 2024 ishin lidhure 36). Aneks kontratat kryesisht ishin për asfaltimin e rrugëve, ndërtimin e kanalizimit dhe renovimin e objekteve të ndryshme. Punët shtesë ishin arsyetuar nga menaxherët e kontratave, dhe ishin aprovuar nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe lejohen edhe me ligj. Megjithatë vërehet qartë se kjo ishte bërë dukuri e shpeshtë gjatë vitit 2024, dhe shkaktarët kryesor për këtë ishin hartimi i dobët i projekteve bazike ku si rezultat i implementimit të tyre pothuajse pjesa dërrmuese e tyre përcillen me kosto shtesë -anekse për tu përmbyllur. Vlen të ceket se komuna e kishte të kontraktuar përmes procedurës së prokurimit një kompani për hartimin e projekteve të ndërtimit të ulët si dhe mbikëqyrjen e projekteve, dhe kishte përzgjedhur në dy rastet të njëjtin operator.

Shkaku përse ka ardhur deri tek kjo situatë është mungesa e mbikëqyrjes nga ana e komunës për projektet të cilat i harton kompania, dhe kjo pastaj ka rezultuar që të ketë shumë aneks kontrata gjatë ekzekutimit të punëve.

**Ndikimi**

Numri i lartë i aneks kontratave nxjerr në pah mangësitë në planifikimin e tyre rrjedhimisht hartimin e dobët të tyre, duke krijuar kosto shtesë të projekteve aktuale. Po ashtu, punët shtesë i rrezikojnë fondet e ndara për projekte tjera duke pamundësuar financimin e projekteve të reja.

**Rekomandimi A7**

Kryetari duhet të sigurohet se të gjitha projektet kapitale janë të planifikuara, hartuara dhe të detajuara mirë përpara inicimit të procesit të prokurimit me qëllim të menaxhimit efektiv të fondeve të këtyre projekteve. Po ashtu, duhet të sigurojë se aneks kontrata përdoret në rastet e jashtëzakonshme dhe vetëm pas plotësimit të kushteve të përcaktuara me ligjin e prokurimit publik.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**



### 2.3.3 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 102,250,471€ , pasurive jokapitale është 1,654,272€, si dhe e stoqeve 196,947€.

#### Çështja A8 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

- Gjetja** Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zhvlerësimi.
- Në regjistrin e pasurive me vlerë mbi 1,000€ kemi identifikuar se komuna ka të regjistruara 511 pasuri në vlerë 12,837,483€ si investime në vijim. Këtu përfshihen pasuri të blera (ndërtuara) gjatë viteve 2011-2019, për të cilat nuk është bërë pranimi teknik edhe pse projektet kanë përfunduar, si dhe projekte të cilat ende nuk kanë përfunduar e që janë në proces ndër vite ose të pezulluara. Për më tepër, nuk mund të kalkulohet zhvlerësimi i këtyre pasurive, pasi ato ende janë të regjistruara si investime në vijim. Ne kemi vërejtur se shpenzimet për hartën zonale të komunës në vlerë prej 190,000€, e cila ishte aprovuar në pjesën e parë të vitit nga kuevendi komunal dhe tashmë është dokument në fuqi, por shpenzimet e krijuara për hartën zonale ende figuronin si investime në vijim.
- Kjo kishte ndodhur për shkak të funksionimit jo të mirë të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.
- Ndikimi** Mungesa e pranimit teknik për pasuritë e përfunduar, apo atyre që janë në proces dhe të pezulluara, ndikon në paqartësinë e statusit dhe raportimit të tyre. Mos regjistrimi i drejtë i pasurive kapitale ndikon që vlera e pasurive jofinanciare të paraqitura në raportin vjetor financiar të jetë e mbivlerësuar.
- Rekomandimi A8** Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduar, dhe regjistrimin e pasurive në përdorim.

#### Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

## 2.3.4 Të arkëtueshmet

Komuna e Gjakovës ka paraqitur kërkesa në PFV për Llogari të arkëtueshme për vitin 2024 në vlerë prej 14,359,438€. Ato kanë të bëjnë me tatimin në pronë prej 12,646,414€, për dhënien e pronës në shfrytëzim 326,893€ dhe tatimit në biznes 1,386,131€. Rritja e të arkëtueshmeve mund të shihet vazhdimisht gjatë viteve krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2024 kërkesat janë rritur për 1,527,083€ ose 11%.

### Çështja B5 - Rritje e llogarive të arkëtueshme

#### Gjetja

Ligji nr. 08/L-176 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që Përmbajnë Procedura të Veçanta Administrative dhe Harmonizimin e tyre me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka hyrë në fuqi më dt. 04.07.2023 dhe ka për qëllim harmonizimin e procedurave të veçanta administrative me procedurën e përgjithshme administrative, i cili ka plotësuar dhe ndryshuar disa ligje dhe një ndër to edhe Ligjin nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Ligji i lartë shënuar përmes nenit 112 ka ndryshuar procedurën e ekzekutimit të vendimit mbi detyrimet tatimore të papaguara, ashtu që për ekzekutimin e këtyre vendimeve (sipas nenit 30 të Ligjit bazik) nuk do të përdoret procedura e përmbartimit privat, por vetë komuna do t'i ekzekutojë duke i përdorur të njëjtat mjete që mund t'i përdor ATK për mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara. Megjithatë, procedura përmbartimore mund të përdoret ndaj faturës së tatimit në pronë. Që nga hyrja në fuqi e këtij ligji nga komuna nuk duhet të iniciohet procedura e përmbartimit ndaj Vendimeve të nxjerra sipas nenit 30 të Ligjit bazik. Po ashtu edhe neni 16 i Rregullorës për Taksa Tarifa, Ngarkesa dhe Shërbimet Komunale, përcakton mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara duke përdorur masat e mbledhjes së detyrueshme.

Llogaritë e arkëtueshme kanë rritje, krahasuar me vitin 2023. Në fund të vitit 2024 të arkëtueshmet ishin rritur për 1,527,083€, kjo vërehet tek ndërmarrjet shoqërore (tatimi në pronë dhe taksa në firmë), ku borxhi ka vlerën prej 4,296,930€. Rritja më e madhe e të arkëtueshmeve është në tatimin në pronë, krahasuar me vitin paraprak këtë vit obligimet ndaj tatimit në pronë janë rritur në vlerë 1,155,865€ apo në masën prej 10%.

Komuna kishte bërë përpjekje për inkasimin e mjeteve të pa arkëtuara nga tatimi në pronë, qiratë nga toka, dyqanet, tregjet apo taksat në firmë, përmes letërkujtesave si dhe vërejtjeve përfundimtare ndaj debitorëve, mirëpo këto masa nuk ishin mjaft efektive dhe trendi i rritjes së obligimeve ndaj komunës është negativ, për faktin e mos dërgimit të borxhlinjëve tek përmbartuesit.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme në arkëtimin e të hyrave.

#### Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave të ngarkuara ndikon në nivelin e fondeve të mbledhura për buxhetin e komunës dhe reflekton negativisht në financimin dhe realizimin e projekteve komunale.

#### Rekomandimi B5

Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbartuesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.

**Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**

### 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

**Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final <sup>5</sup>	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Burimet e fondeve</b>	<b>37,483,964</b>	<b>42,915,318</b>	<b>41,635,481</b>	<b>37,887,249</b>	<b>26,883,540</b>
Grante Qeveritare - Buxheti	32,392,306	33,774,899	33,241,582	29,288,858	22,346,229
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	264,489
Të bartura nga viti i kaluar	0	1,996,746	1,814,808	2,846,991	1,677,526
Të hyrat vetanake	5,091,658	6,687,658	6,228,203	5,163,647	2,557,216
Donacionet vendore	0	46,772	0	0	23,807
Donacionet e jashtme	0	409,243	350,888	587,753	14,272

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 5,431,354€. Kjo rritje është rezultat i Vendimeve të Qeverisë, i bartjes së të hyrave vetjake nga viti paraprak, si dhe donacioneve. Komuna ka shpenzuar 97% të buxhetit final ose 41,635,481€, por duhet të theksojmë se gjatë vitit 2024, komunës përmes vendimeve gjyqësore/përmbarimore ju kanë ekzekutuar rreth 3.2€milon nga kategori të ndryshme ekonomike.


**Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
<b>Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike</b>	<b>37,483,964</b>	<b>42,915,318</b>	<b>41,635,481</b>	<b>37,887,249</b>	<b>26,883,540</b>
Pagat dhe mëditjet	18,843,800	20,242,618	20,237,271	18,295,920	14,345,541
Mallrat dhe shërbimet	4,337,556	4,966,889	4,836,558	4,136,946	3,858,972
Komunalitë	680,000	814,899	784,057	687,330	565,968
Subvencionet dhe transferet	980,000	1,053,976	1,010,565	695,219	614,000
Investimet Kapitale	12,642,608	15,836,936	14,767,031	14,071,834	7,499,060

Shpjegimet për ndryshimet e buxhetit në kategoritë ekonomik janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 1,398,818€, krahasuar me buxhetin fillestar. Kjo rritje vjen nga Vendimet e Qeverisë së Kosovës me vlerë 1,382,593€, si dhe nga donacionet me vlere 16,225€.
- Buxheti final për mallra dhe shërbime ishte rritur për 629,333€. Kjo rritje vjen nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, për 364,377€, nga rritja e tejkalimit të planifikimit për të hyra me vlere 250,000€, si dhe rritje nga donacionet për 14,956€.
- Buxheti final për komunalit ishte rritur për 134,899€. Kjo rritje vjen nga rritja e tejkalimit të planifikimit për të hyra me vlere 130,000€, si dhe nga bartja e të hyrave vetjake nga viti 2023 me vlere 4,899€
- Buxheti final për subvencione ishte rritur për 73,976€, nga kjo vlerë: 71,016€, ishte rritje nga bartja e të hyrave vetjake të pa shpenzuara nga viti 2023, si dhe nga donacionet 2,960€.
- Buxheti final për shpenzime kapitale krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 3,194,328€. Kjo rritje vjen si rezultat i bartjes së të hyrave vetjake të pa shpenzuar nga vitin 2023 për 1,556,453€, nga rritja e tejkalimit të planifikimit për të hyra me vlere 1,216,000€ si dhe rritje nga donacionet për 421,875€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat vetjake të planifikuara për vitin 2024, ishin 5,091,658€, përderisa ishin realizuar 5,844,817€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Po ashtu, komuna për vitin 2024, ka pranuar të hyra nga gjobat nga trafiku dhe gjobat e gjykatës në vlerë totale prej 1,347,176€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme për arsye se këto i planifikojnë dhe realizojnë ministritë e linjës.


**Tabela 3. Të hyrat (në €)**

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
<b>Totali i të hyrave</b>	<b>5,091,658</b>	<b>5,091,658</b>	<b>5,844,817</b>	<b>5,797,084</b>	<b>4,697,952</b>
Të hyrat tatimore	3,138,147	3,138,147	2,308,540	2,742,878	2,296,134
Të hyrat jo tatimore	1,953,511	1,953,511	3,536,069	3,054,205	2,377,763
Të hyrat tjera	0	0	208		24,055

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2023 ka rezultuar me 10 rekomandime. Komuna kishte përgatitur Planin e Veprimit ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, pesë(5) rekomandime janë zbatuar dhe pesë(5) rekomandime nuk janë zbatuar ende, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr.4.

**Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak**



**Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak**

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të shtojë masat e kontrollit në menaxhimin e kontratave dhe të siguroj se menaxherët e kontratave dhe mbikëqyrësit e tyre të mos aprovojnë situacione të punëve të pa përfunduara në të kundërtën të rishikojnë pagesat e çdo situacioni me qëllim të barazimit para ekzekutimit të pagesës së fundit.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë vendosjen e kontrolleve në këtë fushë me një mbikëqyrje rigorozë në menaxhimin e kontratave. Realizimi i kontratave të bëhet në përputhje me planin dinamik/afatin për kryerjen e punëve/furnizimeve dhe për vonesat e pa arsyetuara, të aplikohen masat/ndëshkimet e parapara në kontratë.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

3.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se kontrollet brenda drejtorive janë efektive në mënyrë që tarifat e përcaktuara të aplikohen drejtë dhe saktë në mënyrë që mos të dëmtohen pranuesit e këtyre shërbimeve.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
4.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme), që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
5.	Të hyrat	Kryetari të sigurojë përmirësimin e procesit të organizmit të veprimtarive inspektuese sipas kritereve ligjore të përcaktuara në mënyrë që ndryshimet eventuale nga inspektimet të jenë regjistruar, ashtu që shënimet rreth tatimit në pronë të janë të plota.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
6.	Mallrat dhe shërbimet dhe komunalitë	Kryetari të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi sa i përket realizimit të pagesave, në mënyrë që gjatë procedimit të pagesave, të bëhet fillimisht zotimi i mjeteve, pastaj të nxirret urdhër blerje dhe në fund të pranohet malli/shërbimi dhe të kryhet pagesa.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
7.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë ndjekjen e trajnimeve për menaxherët e projekteve, për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
8.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se funksionon kontrolli i duhur përmes zyrës së prokurimit, ashtu që, të rishikoj se njësitë kërkuese bëjnë hartimin e specifikimeve teknike sipas kërkesave ligjore dhe nevojave të komunës duke përcaktuar standardin e cilësisë së punës apo furnizimit.	Janë ndërmarrë veprimet e nevojshme, dhe kemi vërejtur se rekomandimi është zbatuar.	I zbatuar
9.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të analizoj efektivitetin e mekanizmave në dispozicion për mbledhjen e të arkëtueshmeve, duke përfshirë edhe veprimet ligjore shtesë përmes përmbauesve, për të siguruar arkëtimin e plotë të tyre.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin

10.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të siguroj se hyrja në obligime bëhet vetëm pasi mjetet buxhetore të jenë zotuar paraprakisht, si dhe obligimet financiare ndaj kontraktuesve të paguhen brenda 30 ditëve nga data e pranimin të faturave në mënyrë që të shmangen pagesat shtesë të interesit nga vendimet gjyqësore/përmbartimore.	Përkundër veprimeve të cilat i ka marrë komuna, kemi vërejtur se rekomandimi ende nuk është zbatuar.	Nuk ka filluar zbatimin
-----	-----------------------	---	--	-------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Lavdim Maxhuni, Drejtor i Auditimit



Fejzullah Fejza, Udhëheqës i ekipit



Ejup Simnica, Anëtar i ekipit



Nebojsa Ristić, Anëtar i ekipit



Muharrem Qyqalla, Anëtar i ekipit



## Shtojca I: Letër konfirmimi



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Gjakovës, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet;
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

**Ardian Gjini**

**Zyrtari Kryesor Administrativ**

Data: 23 maj 2025

Gjakovë



## Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare<sup>6</sup> duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet<sup>7</sup>, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

### Forma e opinionit

#### Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

## Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

### Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

### Opinionit i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

**Mohim i opinionit**

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

**Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit**

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

## Shënimet fundore

- <sup>1</sup> Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- <sup>2</sup> Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- <sup>3</sup> Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- <sup>4</sup> Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja  
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura  
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- <sup>5</sup> Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- <sup>6</sup> Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- <sup>7</sup> Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.